
**COMMON TRADITIONAL NORMS AGAINST LEGAL NORMS ON THE FAMILY
PROPERTY INHERITANCE DISTRIBUTION BETWEEN GENDERS AMONG THE
ALBANIANS OF NORTH MACEDONIA**

Lindita Neziri-Ceka

SEE University, R. of North Macedonia, lc06876@seeu.edu.mk

Abdulla Azizi

SEE University, R. of North Macedonia, a.azizi@seeu.edu.mk

Abstract: Despite the historical development and political system, in Northern Macedonia and other Balkan countries, the Albanian community for both sexes has formally had equal access to the inheritance of parental property, however it is rare for a female heir to receive her legal share. The fact is that formal institutions are not strong enough to prevent this form of discrimination. The paper aims to analyze the situation with the transfer of ownership to the heirs (sons and daughters) of the Albanian community of Northern Macedonia, where in the past and to some extent there are gender prejudices in favor of boys in terms of social privileges, especially those in relation to inheritance. The influence of habits has continued unabated and continues today to exclude women from family ownership. The Albanian family has functioned for centuries according to the patriarchal model, which is characterized by a mentality based on the reasoning that boys are the ones who will take care of their parents when they grow old and consequently-the inheritance of family property is meant as a reward for their commitment to parents. Among other things, this is due to the institutional miss-regulation of care for the elderly, especially those who don't have an old-age pension, and as a result, the care of the elderly necessarily depends on the good will of the male heir's. From this point of view of caring for elderly parents with whom the heir's sons continue to live, we can find the reason for this custom-tradition. The paper has its limitations and focuses only on the exclusion of girls from the inheritance of family property, and doesn't include marital property and other forms of ownership. This paper aims to support the efforts of practitioners and policy makers working towards achieving gender equality in general. Here are highlighted the strengths, weaknesses and opportunities in the legal framework for gender equality in property and helps determine the main areas where legal reform is needed. In terms of methodology, historical methods, analysis methods, comparative methods, interviews and surveys have been used.

Keywords: gender equality, heritage, customs, laws.

**E DREJTA ZAKONORE PËRKUNDREJT NORMAVE LIGJORE MBI NDARJEN E
TRASHËGIMISË PRONËSORE FAMILJARE MES GJINIVE TEK SHQIPTARËT E
MAQEDONISË SË VERIUT**

Lindita Neziri-Ceka

SEE University, R. of North Macedonia, lc06876@seeu.edu.mk

Abdulla Azizi

SEE University, R. of North Macedonia, a.azizi@seeu.edu.mk

Abstrakt: Pavarësisht zhvillimit historik dhe sistemit politik, në Maqedoninë e Veriut dhe në vendet tjera ballkanike, komuniteti shqiptar për të dy gjinitë formalisht ka pasur qasje të barabartë në trashëgiminë e pronës prindërore, megjithatë rrallëherë ndodh që një vajzë të mer pjesën e saj ligjore. Fakt është se institucionet formale nuk janë të forta për të parandaluar këtë formë të diskriminimit. Punimi ka për qëllim të analizon situatën me bartjen e pronësisë tek trashëgimtarët (djem dhe vajza) te komuniteti shqiptar i Maqedonisë së Veriut, ku në të kaluarën edhe deri diku tani ekzistojnë paragjykimë gjinore në favor të djemve për sa i përket privilegjeve shoqërore, veçanërisht atyre lidhur me trashëgiminë. Ndikimi i zakoneve ka vazhduar pa ndërprerë edhe sot vazhdon t'i përjashton femrat nga pronësia familjare. Familja shqiptare me shekuj ka funksionuar sipas modelit patriarkal, që karakterizohet me një mentalitet të bazuar në arsytimin se djemtë janë ata të cilët do të kujdesen për prindërit kur ata të plaken dhe rrjedhimisht-trashëgimia e pronës familjare nënkuptohet si një shpërblim për përkushtimin e tyre ndaj prindërve. Ndër të tjera, kjo është edhe si pasojë e mosrregullimit institucional të kujdesit ndaj të moshuarëve, sidomos atyre që nuk kanë pension pleqërie dhe si pasojë, përkujdesja e të moshuarëve domosdoshmërisht varet nga vullneti i mirë i djemve. Nga ky këndvështrim i përkujdesjes për prindërit e thyer në moshë me të cilët vazhdojnë të jetojnë djemtë e trashëgimtarit, mund të gjejmë arsyen e këtij zakoni-tradite. Punimi ka kufizimet e veta dhe

fokusohet vetëm në përjashtimin e vajzave nga trashëgimia e pronës familjare, dhe nuk përfshin pronën bashkëshortore dhe format e tjera të pronësisë. Ky punim synon mbështetjen e përpjekjeve të praktikuesve dhe hartuesve të politikave që punojnë drejt arritjes së barazisë gjinore në përgjithësi. Këtu janë theksuar pikat e forta, dobësitë dhe mundësitë në kuadrin ligjor për barazinë gjinore në pronë dhe ndihmon në përcaktimin e fushave kryesore ku nevojitet të bëhen reforma ligjore. Për sa i përket metodologjisë, është përdorur metoda historike, metoda e analizës, metoda krahasuese, intervista dhe anketa.

Fjalët kyçe: barazia gjinore, trashëgimia, zakonet, ligjet.

1. HYRJE

Pas fitimit të pavarësisë në vitin 1991 Maqedonia e Veriut miratoi një sërë ligjesh dhe konventash ndërkombëtare, të cilat formalisht tentojnë që të garantojnë barazinë gjinore. Por, shoqëria nuk justifikon barazinë gjinore në të gjitha sferat e jetës, veçanërisht jo në ndarjen e pronës familjare në mënyrë të barabartë për fëmijet e të dy gjinive. Kjo nënkupton se aktet juridike nuk përputhen me vlerat kulturore të shoqërisë dhe si rezultat i kësaj, pabarazia gjinore paraqitet si problem jetik në shoqëri dhe praktika e detyrimit të dhënies si “dhuratë të pjesës ligjore nga trashëgimia” ua pamundëson vajzave të marrin hisen e tyre në trashëgimi (UN Women, 2019). Fatkeqësisht akoma nuk ka mekanizma për të vënë në praktikë barazinë në këtë fushë (EPRS, 2017). Akoma, një pjesë e kosiderueshme e komunitetit shqiptar në Maqedoninë e Veriut akoma funksionon sipas një tradite patriarkale, ku normat tradicionale përjashtojnë zbatimin e frymës së ligjeve mbi barazinë, veçanërisht ato në lidhje me të drejtat e grave.

Barazia gjinore mbetet një çështje kryesore në jetën e përditshme dhe si e tillë kërkon hulumtime të vazhdueshme gjithëpërfshirëse. Në të shumtën e rasteve, vetëm format fizike, psikologjike ose seksuale të dhunës kundër grave mund të trajtohen si diskriminim gjinor, ndërsa disa forma të tjera të dhunës në familje pothuajse nuk diskutohen publikisht. Forma e “dhunës ekonomike”, është një nga temat më të rëndësishme, por më pak të studiuara të padrejtësisë dhe diskriminimit ndaj femrave. Zakonisht, pavarësia ekonomike kryesisht diskutohet në kontekstin e punësimit dhe jo në kontekstin e shpërndarjes së trashëgimisë, edhe pse ky i fundit mjaft i rëndësishëm për sa i përket diskriminimit (Council of Europe, 2018:6).

Edhe pse legjislacioni u jep vajzave qasje të barabartë në pronën e prindërve, normat dhe traditat kulturore janë aq të forta sa që në shumicën e rasteve ato mbesin pa trashëgimi. Disa femra me vetëdije refuzojnë të përdorin të drejtat e tyre mbi trashëgiminë e prindërve, ndërsa të tjerat aspak nuk janë të informuara për të drejtat e tyre.

Të drejtat e trashëgimisë së gruas përsëri ndryshime përgjatë shekujve. Në përgjithësi, prona e një gruaje përbëhet nga një dhuratë e caktuar nga prindërit e saj. Shuma e dhuratës ishte e rregulluar kryesisht nga traditat dhe zakonet dhe konsistonte në ndonjë pronë të brendshme si ari, orendi për shtëpi etj. Kushtet bashkëkohore socio-ekonomike përcaktuan rregullat e reja të normave të martesës, edhe pse domethënia e dhuratave e ruajti akoma rëndësinë dhe kuptimin e tyre, si diçka që rruhet vazhdimisht nga brezi në brez “për të cilën nuk thuhet asgjë, si e mirëqenë e cila gjithmonë ka qenë ashtu siç është” (Berger & Luckmann, 1967:24).

Në përgjithësi, tek komuniteti shqiptar në Ballkanin Perëndimor akoma traditat luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e praktikave shoqërore.

Në këtë rast, normat ligjore nuk janë në përputhje me vlerat kulturore, ndërsa barazia nuk reflektohet në shoqëri. Shpërndarja e pabarabartë e trashëgimisë nuk shihet si e padrejtë nga burrat, ndonjëherë edhe gratë nuk e vlerësojnë atë si të padrejtë.

Megjithëse, vajzat nuk kanë mundur t'i mbrojnë të drejtat e tyre të dhëna me ligj, si pasojë kjo ka çuar në zhvillimin e pozitave të pabarabarta për burrat dhe gratë në pushtet dhe në familje.

2. MATERIALET DHE METODAT

Arsyetimi për këtë studim rrjedh nga dallimet praktike mes zbatimit të normave ligjore pozitive dhe praktikës zakonore. Kjo mospërputhje ka bërë të papërshtatshëm efektivitetin e sistemit ligjor shtetëror në adresimin e pabarazive gjinore. Kjo sfidë është më e theksuar në kontekstin dallimeve që lidhen me shkallen e zhvillimit ekonomik por edhe intelektual, si dhe nivelin e civilizimit të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Është e domosdoshme të shqyrtohet mundësia e reformave ligjore dhe institucionale, e shoqëruar me veprime dhe aksione pragmatike që mund të fuqizojnë normat ligjore dhe njëherit të zbutin efektin negativ të zakoneve në zhvillimin e të drejtave të barabarta gjinore.

Ky studim ka një qasje të kombinuar teoriko-empirike, e cila përfshin një rishikim kritik të literaturës shkencore mbi të drejtën zakonore dhe ndikimin e praktikimit të saj tradicional në çështjet e barazisë gjinore në jetën e përditshme. Në këtë hulumtim përdoren edhe metoda deskriptive, analitike dhe komparative në shqyrtimin e dispozitave kushtetuese, legjislacioneve dhe praktikave relevante për lëndën e hulumtimit. Poashtu, fokusi kryesor i këtij punimi është dhënë studimit empirik të rasteve të përfunduara të trashëgimisë përmes intervistës, si dhe anketës se si do të ishte më së miri të ndahet pronësia mes trashëgimtarëve meshkuj dhe femra brenda familjes.

3. REZULTATET

Në këtë hulumtim, kam përdorur anketën dhe intervistën. Janë anketuar 280 vajza/gra, duke respektuar rregullat e përfaqësimit 50%-50% fshat-qytet, të shkolluara-të pashkolluara, të punësuar-papunë etj. Duhet potencuar se rrezultatet shprehin qasjen subjektive përkundrejt kulturës së përgjithshme. Mbetet e paqartë nëse këta të anketuara do të shpërndanin pronën e tyre në mënyrë të barabartë tek fëmijët e tyre, ose konstatimi i tyre del nga përvoja që kishin ato në suaza të familjes së tyre.

Në përgjithësi, studimi përpiqet të përcaktojë ndikimin e praktikës dhe të drejtës zakonore të trashëgimisë mbi pabarazinë gjinore, duke u dhënë përgjigje pyetjeve specifike kërkimore.

Pyetje hulumtuuese: <i>Si duhet të ndahet pronë e prindërve midis birit dhe vajzës?</i>		
Përgjigjet	Pronë e Patundshme: Shtëpi, banesë, tokë, kompani etj	Pronë e tundshme: veturë, ari, xhevahire, para, maqineri dhe pajisje të tjera të lëvizshme etj
Pjesa më e madhe duhet t'i jepet djalit	74%	26%
Duhet ndarë në mënyrë të barabartë	66%	34%
Pjesa më e madhe duhet t'i jepet vajzës	25%	75%
Duhet t'i jepet tërësisht vajzës	33%	67%
Duhet t'i jepet tërësisht djalit	76%	24%

Poashtu, janë realizuar 8 intervista me vajza/gra nga familjet të cilat kanë përfunduar ligjërisht procesin e trashëgimisë pronësore në familjet e tyre të prejardhjes.

- Rasti 1. *“Kur i thashë vëllait tim se edhe unë kam hise në këtë shtëpi, ai nuk la të zezë pa më thënë”, kështu rrëfen mes të tjerash, A.S nga Tetova, e cila aktualisht jeton me ndihmë sociale, ndërkohë që po rrit tre fëmijë. “Kërkesa ime për pjesëmarrje në pronën e prindërve ishte e arsyetuar sepse kisha nevojë ekonomike nga njera anë, dhe nga ana tjetër isha viktimë e dhunës nga bashkëshorti, i cili në pamundësi për të gjetur një punë stabile, tërë energjinë negative e shprehte ndaj meje”.*³⁰
- Rasti 2. *“Babai ua ndau pasurinë vëllezërve, për mua as që u diskutua”, potencon B.A nga Gostivari. “Unë njëkohësisht kam studiuar dhe punuar. Aq më tepër, krahas plotësisht të nevojave të mia, kam ndihmuar edhe familjen. Më vjen keq që kontributi im u harrua, kur prindërve të mi ua shpreha kërkesën për përfshirje në trashëgimi. Kur kuptova se pasuria e prindërve ndahet mes vëllezërve, unë me keqardhje mund të them se jam e zhgënjyer dhe diskriminuar. Për mua, as që është diskutuar”.*³¹
- Rasti 3. *“Tokën e babait nuk e shoh si diçka të ndashme, por ju takon vetëm meshkujve si breza të cilët do të vazhdojnë trashëgiminë”, theksoi S.B. nga Dibra.*³²
- Rasti 4. *“Toka dhe shtëpia duhet tu takojnë vëllezërve, ndërsa shkollimi dhe ndonjë dhuratë e patundshme do të ishte e mirëseardhur”, theksoi F.B nga Kumanova.*³³
- Rasti 5. *“Edhe pse e di që nuk është e padrejtë, por nëse pretendoj për trashëgimi atëherë automatikisht duhet me i shkëput marrëdhëniet familjare me prindërit dhe vëllezërit”, theksoi M.F nga Struga.*³⁴
- Rasti 6. *“Tradita më nuk duhet të jetë bazë për ndarjen e trashëgimisë sepse kanë ndryshuar kushtet nga e kaluara, ndërsa duhet respektuar ligji pozitiv që ndjek në hap edhe emancipimin e femrës në kohën bashkëkohore”, theksoi F.M nga Manastiri.*³⁵
- Rasti 7. *Në përgjithësi, deri në fillim të shekullit XX (fazën e hershme të emancipimit të femrës shqiptare) femrat nuk kanë pasur të drejtë të zgjedhin partnerin e tyre, vetëm prindërit kishin autoritetin për të planifikuar martesën e vajzës së tyre dhe për të bërë marrëveshje financiare me dhëndrin e tyre të ardhshëm.*³⁶
- *Ngjashëm me traditën shqiptare, “Në të kaluarën, pjesë e traditës maqedonase ishte që pasuria dhe trashëgimia t’u ndahej vetëm meshkujve të familjes, shprehet E.A nga Shkupi. Për gratë është konsideruar*

³⁰ Pjesë e shkëputur nga Intervista, e realizuar me datë 13.01.2020

³¹ Pjesë e shkëputur nga Intervista, e realizuar me datë 19.02.2020

³² Pjesë e shkëputur nga Intervista, e realizuar me datë 22.02.2020

³³ Pjesë e shkëputur nga Intervista, e realizuar me datë 16.03.2020

³⁴ Pjesë e shkëputur nga Intervista, e realizuar me datë 18.03.2020

³⁵ Pjesë e shkëputur nga Intervista, e realizuar me datë 05.04.2020

³⁶ Kryesisht, paratë që u jepte familja e dhëndrit-familjes së nuses së fejuar kanë pasur për qëllim mbulimin e shpenzimeve për përgatitjen e vajzës për veshjet e saj dhe dhuratat që nusja do tua sjell familjarëve të dhëndrit. Pjesë nga intervista me një grua të moshuar, XH.I nga rrethi i Tetovës, me datë 15.01.2020

se kur ato martohen, e ndryshojnë mbiemrin dhe me këtë pushojnë së qenuri trashëgimtare. Pabarazia ishte e pranishme kryesisht në fshat, deri diku edhe në qytete. Ka ndodhur që motrat, për shkak të presionit të anëtarëve meshkuj të familjes, kanë hequr dorë nga trashëgimia, ndërkohë që gratë në zonat rurale nuk e kanë pasur vetëdijen e zhvilluar për të drejtat e tyre. Por, me ndryshimin e sistemit, me modernizimin, gjërat kanë ndryshuar pozitivisht dhe sot gratë e komunitetit maqedonas në pjesën më të madhe janë të vetëdijshme për të drejtat e tyre, madje në qoftë se një anëtar mashkull i familjes dëshiron të jetë trashëgimtar i vetëm, femra të drejtat e saj i arrin përmes gjykatës”.³⁷

4. DISKUTIME

Në këtë hulumtim mund të veçojmë dy konstatime të cilat rrjedhin nga anketat:

- Të dhënat nga pyetësi tregojnë se të anketuarit më lehtë japin vajzave një pjesë të pronës së luajtshme sesa pronën e patundur;
- Të anketuarit japin preferencë për trashëgimi djemve krahasuar me vajzat.

Ndërsa, nga intervistat mund të konstatojmë se ...me rritjen e nivelit të shkollimit të vajzave në tre dekadat e fundit, gjërat kanë filluar të ndryshojnë pozitivisht dhe sot gratë e komunitetit shqiptar në pjesën më të madhe janë të vetëdijshme për të drejtat e tyre, edhe pse një pjesë e mirë e tyre akoma po hezitojnë të realizojnë të drejtat e tyre përmes një procesi gjyqësor.

Natyrish, një reformë e suksesshme ligjore varet shumë nga gatishmëria për ndryshim e autoriteteve vendimmarëse, por gjithashtu nga vetë gatishmëria brenda familjes. Disa ndryshime legjislative mund të pranohen më lehtë sesa të tjerat, por dialogu, ngritja e vetëdijes dhe angazhimi i shoqërisë civile mund të sjellin risi në zhvillimin e përpjekjeve për barazi gjinore në pronë.

Edhe pse pabarazia gjinore është e dukshme, ajo nuk shihet si padrejtësi. Disa forma të dhunës shihen si të justifikuar, pasi ato janë pjesë e normave shoqërore të përhapura që e tolerojnë një sjellje të tillë. Prandaj, pabarazia gjinore dhe dhuna ndaj grave kanë nevojë për vëmendje dhe hulumtim adekuat për të zbuluar këtë shtypje dhe padrejtësi.

Vetë një pjesë e femrave të pashkolluara nuk pranojnë se të drejtat e tyre janë shkelur, meqë diskriminimi perceptohet si rregull e traditës dhe fakt me të cilin janë mësuar të jetojnë (Petrovska, 2017: 11-28). Kjo traditë kalon në mënyrë të pandërgjegjshme nga brezi në brez, dhe gratë bëjnë të njëjtën gjë me fëmijët e tyre siç janë trajtuar nga prindërit e tyre (Vangeli, 2009). Nganjëherë, gratë nuk e kuptojnë atë që kanë humbur, por vetëm se thiren në ruajtjen e raporteve të mira brenda familjes me vëllezërit e tyre. Kjo pasiqë nga këndvështrimi i marrëdhënieve të mira familjare mes vëllait dhe “motrës së mirë”, bazohet në supozimin se meshkujt janë trashëgimtarët e vetëm të pronës familjare, ndërsa harmonia zgjat vetëm derisa motrat nuk e kërkojnë pjesën e tyre të trashëgimisë.

Edhe pse normat pozitive ligjore parashohin barazi gjinore, diskriminimi strukturor është aq i fortë sa që femrat i bën të papërshtatshme në qasjen deri tek barazia në pronë (USAID, 2019). Normat kulturore janë aq të forta sa që diktojnë trashëgimtarët femra që të refuzojnë të drejtat e tyre në favor të meshkujve. Diskriminimi strukturor është i ashpër, i mbështetur nga normat e traditës.

Rastet gjyqësore të trashëgimisë vëllezër-motër ndodhin shumë rrallë. Vajzat nuk duan ta sjellin çështjen në publik, sepse ata nuk duan që njerëzit ta diskutojnë këtë, dhe nëse gratë i drejtohen gjykatës atëherë të gjithë të afërmit do të dinë për këtë dhe kjo do të konsiderohet si një rast i turpshëm. Në të shumtën e rasteve, motrat nuk shkojnë tek gjykata të kërkojnë të drejtat e trashëgimisë: seancat gjyqësore mes motrës dhe vëllait janë të rralla dhe në shumicën e rasteve këto ndodhin si konsultime. Gratë nuk shkojnë në gjykatë jo sepse nuk duan, por sepse shoqëria do të përgjigjet në një mënyrë shumë negative dhe stereotipet shoqërore do të dalin në shprehje (International BPU, 2015). Ndonjëherë gratë nuk nxitin proces gjyqësor edhe për arsye financiare pasi nuk janë në gjendje të paguajnë për shërbimet ligjore. Ato duhet të paguajnë avokatin paraprakisht nëse humbasin procesin. Përveç kësaj, ata duhet të paguajnë një tarifë për seancën gjyqësore dhe gjithashtu për ekspertizën e vlerës së pasurisë.

Kohët e fundit, shumë gra janë bërë shtylla e familjes së tyre, por kjo nuk ka ndryshuar gjendjen e tyre sociale; ata nuk mundin të luftojnë kundër normave patriarkale. Një nga arsyet për këto norma është besimi i fortë se meshkujt funksionojnë si vazhdimësi e linjes patrimoniale. Një faktor tjetër është se djali shpesh qëndron me prindërit e tij, ndërsa vajza shkon për të jetuar me familjen e burrit të saj. Pritet që djemte të kujdesen për prindërit e tyre dhe kjo shpesh përdoret për të justifikuar pretendimet e tyre për trashëgiminë e plotë të pronës së prindërve të tyre. Në veçanti, kur prindërit kanë vetëm një shtëpi dhe nuk mund ta ndajnë atë.

Është një supozim me bindje të thellë se trashëgimtari kryesor duhet të jetë djali, ndërsa vajza duhet të jetë e kënaqur me një dhuratë që përbëhet nga paratë ose pasuria e paluajtshme. Është aq e padiskutueshme që edhe gratë nuk kanë

³⁷ Pjesë e shkëputur nga Intervista, e realizuar me datë 11.01.2018

ndjenjën e protestës. Në të kundërtën, kur vajzat nuk janë në gjendje të ushqehen ose të kujdesen për veten e tyre dhe fëmijët e tyre ose në rastet kur vajzat janë viktime të dhunës familjare nga bashkëshorti, atëherë atyre prindërit zakonisht u lejojnë që të kthehen në shtëpi, veçanërisht nëse vajza është viktimë e dhunës dhe nuk qëndron mirë ekonomikisht (Neziri & Azizi, 2018).

Në raste të caktuara, kur vajzat i kanë raportet bashkëshortore jonormale, ata duhet të zgjedhin ose vazhdojnë të durojnë dhunën ose vendosin të kthehen në shtëpinë e prindërve për të bashkëjetuar me vëllezërit dhe familjet që kanë krijuara ata. Në të kundërtën, kur martohet një vajzë e fuqishme financiarisht, ajo bëhet dominuese dhe situata financiare ndryshon shumë gjëra.

Janë të nevojshme përpjekjet e përbashkëta të qeverisë dhe OJQ-ve, në veçanti përmes ligjeve pro-aktive, fushatave informative dhe programeve të reja për edukim qytetar. Me një fjalë, ka shumë për t'u bërë për të inkurajuar gratë që të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën sociale.

5. KONKLUZAT

- Akoma ekziston një hendek i madh midis situatës ekzistuese dhe realitetit të dëshiruar mbi barazinë gjinore në trashëgimi
 - Edhe pse pabarazia gjinore është e qartë, shpesh kjo nuk perceptohet si diskriminim. Përkundrazi, qasja jo e barartë deri diku justifikohet në bazë të normave të gjera sociale dhe kulturore
 - Edhe në situata shumë të vështira, vajzat nuk e kontestojnë vullnetin e vëllezërve dhe prindërve të tyre, duke ditur se mund të shkatërrojë marrëdhëniet familjare
 - Ndërhyrja legjislativë është e mjaftueshme për të ç'rrenjos padrejtësitë tradicionale kundër vajzave
 - Nëse një grua/vajzë nuk ka punë, ajo vazhdon të qëndron ekonomikisht e varur nga burri i saj dhe kjo në disa raste krijon një situatë të pashmangshme të dhunës në familje
 - Pritjet për përmirësim të situatës duke u bazuar në normat juridike e kanë humbur rëndësinë e tyre, dhe vajzat/gratë marrin pak ose aspak nga prona apo burimet financiare nga familja e prindërve të tyre
 - Institucionet kryesore publike nuk janë të përfshira në zbatimin e ligjit të barazisë gjinore dhe nuk sistematizojnë të dhënat përkatëse. Nuk ka të dhëna zyrtare se sa vajza/gra refuzojnë të marrin trashëgiminë pronësore nga prindët e tyre dhe pse?
 - Mungon një programi kompleks që do të mbulojë fuqizimin dhe edukimin ligjor, për të inkurajuar një shoqëri të barabartë dhe të drejtë për vajzat/gratë. Programet arsimore do të duhej që të ndryshojnë situatën hap pas hapi në drejtim të transformimit të ideve në një nivel personal dhe kulturor
 - Mungojnë fushata që inkurajonë vajzat/gratë të angazhohen në marrjen e pjesës trashëguese e cila u takon.
- Duke pasur, parasysh konkluzat e mësipërme, janë dhënë disa rekomandime për të përmirësuar gjendjen:
- Duhet të përpunohen të dhënat statistikore të cilat do të shërbejnë për planifikimin e politikave vijuese
 - Ligji mbi barazinë gjinore duhet t'i udhëzon institucionet publike për të mbledhur/mbajtur statistika në sferën e barazisë gjinore
 - Presioni ndaj vajzave kur ato kërkojnë trashëgimi duhet të adresohet në mënyrë eksplicite deri tek institucionet nga vetë palët e interesuara
 - Gjykatat/Noterët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë të dhënat statistikore mbi trashëgiminë midis motrave dhe vëllezërve për çdo vit deri tek institucionet gjegjëse të cilat mbikëqyrin barazinë gjinore
 - Ekziston nevoja për reforma ligjore dhe institucionale si dhe për ndërgjegjësim dhe sensibilizim të popullatës mbi çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin e bazuar në trashëgimi
 - Duhet të përcaktohen qëllime afatmesme dhe afatgjata për të menaxhuar dhe përmirësuar barazinë gjinore në trashëgimi. Zakonisht, duhet punuar thellë në eliminimin e stereotipeve, përmes organizimit të trajnimeve, programeve në shkolla dhe universitet; diskutimeve, takimeve, shfaqjeve të filmave dhe të gjitha mënyrave të mundshme për të ofruar informata të sakta mbi mundësitë e barabarta gjinore. Në shkollë duhet t'u mësojmë nxënësve edukimin qytetar dhe të shpjegojmë se çfarë do të thotë barazia e meshkujve dhe femrave, jo vetëm në kontekstin ligjor, por edhe në jetën reale, kur njerëzit krijojnë familje dhe duhet të ndajnë trashëgiminë e tyre, ata duhet të mbajnë një balancë pa preferenca gjinore.

REFERENCAT

- Berger, P.L., & Luckmann, T. (1967). *The social construction of reality*. Anchor books, 24.
- Neziri & Azizi. (2018). *Правна основа за наследство на имот во РМ и меѓународни практики*. Меѓународен дијалог: Исток-Запад (Право и Политикологија), Меѓународен Центар за Славјанска Просвета, Година 5, Број 2, Април 2018, Свети Николе, Република Македонија, 21-26.

- Neziri & Azizi. (2018). Between Law and Traditions: the Practice of (Non) Participation of Girls from the Albanian Community in Macedonia in the Family Property Inheritance. *European Journal of Interdisciplinary Studies*, January-April 2018 Volume 4, Issue 1. 57-66.
- Council of Europe. (2018). *Stratégie du Conseil de l'Europe pour l'égalité entre les femmes et les hommes 2018-2023*, April 2018, 6-9.
- International, B. P. U. (2015). *Macedonia investment and business guide: Strategic and practical information*. Place of publication not identified: Intl Business Pubns Usa.
- DCAF, OSCE/ODIHR, UN Women (2019) "Justice and Gender", in *Gender and Security Toolkit*. Geneva. 17-42
- EPRS-European Parliamentary Research Service (2017). *Rights and empowerment of women in the Western Balkans*. European Union Briefing, June 2017
- Petrovska B. (2017). *Multidimensional poverty analysis of RM*. Federation of Farmers of the Republic of Macedonia, Skopje, 2017. 11-28
- Vangeli A. (2009). *Women's effective property and inheritance rights in the Republic of Macedonia in: Achieving gender equality in Macedonia*. Center for research and policy making, 2009. Skopje. 51-74
- USAID/North Macedonia gender analysis report (2019). *Banyan Global- Washington DC*. July 2019, 3-17.